

Terma Reference

Thirrje për ekspert për hartimin e modulit dhe zhvillimin e trajnimit për ofrimin e shërbimeve sociale të specializuara me profesionistët e shërbimeve sociale në Bashkinë Korçë dhe Durrës

Konsulencë	Thirrje për ekspert për hartimin e modulit dhe zhvillimin e trajnimit për ofrimin e shërbimeve sociale të specializuara me profesionistët e shërbimeve sociale në Bashkinë Korçë dhe Durrës
Kohëzgjatja e shërbimit	Korrik 2025 - Shtator 2025
Zona e projektit	Bashkia Korçë
Data e mundshme e fillimit të punës	Korrik 2025

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontrakttojë një ekspert, për të zhvilluar një modul trajnimi mbi ofrimin e shërbimeve sociale të specializuara. Ky modul do të përdoret për trajnimin e profesionistëve ofrues të shërbimeve sociale, në Bashkinë Korçë dhe Durrës, në kuadër të programit Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe World Vision Albania.

Ekspertiza do të ofrohet në mbështetje të Bashkisë Korçë dhe Durrës, drejtorive përkatëse të shërbimeve sociale, Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen dhe Nisma ARSIS, me synim forcimin e kapaciteteve profesionale të ofruesve të shërbimeve sociale në nivel vendor për të garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore për fëmijët dhe familjet në nivel të lartë cënueshmërie përfshirë dhe fëmijët pa kujdes prindëror.

Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA ARSIS është angazhimi për avancimin e të drejtave të fëmijëve, të rinjve dhe familjarëve të tyre që përballen me vulnerabilitet, duke ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe duke lehtësuar integrimin me dinjitet të tyre në shoqëri. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrimi i Projektit

Projekti po zbatohet në Bashkinë Korçë "Forcimi i krijimit dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social për të mbrojtur fëmijët dhe komunitetet vulnerabël në Bashkinë e Korçës dhe Durrësit" në kuadër të programit Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga

UNICEF Albania dhe World Vision Albania. Metodologjia e propozuar bazohet në parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (CRC), standardeve ndërkombëtare të kujdesit alternativ për fëmijët dhe prioritetet kombëtare, duke përfshirë programin e Qeverisë së Shqipërisë, i cili synon të avancojë një sistem të mbrojtjes sociale gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm për të mbështetur individët gjatë gjithë ciklit të jetës. Ajo përdor një model socio-ekologjik që vendos fëmijën në qendër të të gjitha ndërhyrjeve, i rrethuar nga katër shtresa kryesore: kujdestarët/familja, komuniteti, kultura dhe shoqëria, si dhe mjedisi më i gjerë/politikat.

Në Bashkinë Korçë, Qasja përqendrohet në krijimin e një modeli të plotë dhe multidisiplinor të shërbimeve, i cili ka në prioritet integrimin e kujdesit dhe mbrojtjes sociale, me fokus në përfitimet për fëmijët, mbështetjen familjare dhe përmirësimin e cilësisë dhe aksesit të shërbimeve të kujdesit. Nevojat e menjëhershme dhe afatgjata të fëmijëve adresohen përmes planeve të mbështetjes individuale dhe menaxhimit të integruar të rasteve. Këto përfshijnë këshillimin, terapinë dhe ndihmën psikosociale për të forcuar qëndrueshmërinë emocionale, së bashku me mbështetje të personalizuar arsimore dhe aktivitete të përfshirjes në komunitet. Qëllimi është të sigurohet që çdo fëmijë të zhvillohet në një mjedis të kujdesshëm që ka në prioritet mirëqenien, zhvillimin dhe ndjeshmërinë e tij/saj ndaj çështjeve gjinore. Projekti fuqizon kujdestarët, duke përfshirë familjet biologjike, ofruesit e kujdestarisë alternative dhe stafin institucional, me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të ofruar kujdes cilësor.

Në Bashkinë Durrës, projekti synon krijimin e një strukture të qëndrueshme për shërbimet mbështetëse për fëmijët dhe familjet, duke integruar ekipe në mbështetjen e familjes, kujdesin alternativ dhe shërbimet komunitare. Fokusi është në bashkëpunimin me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, NJVNR dhe aktorët lokalë për identifikimin e hershëm të rasteve dhe parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja. Kapacitetet e stafit të institucioneve dhe qendrave komunitare do të fuqizohen përmes trajnimeve dhe mbështetjes afatgjatë në punë. Programi përfshin mbështetje për familjet në rrezik, duke siguruar shërbime multidisiplinore si ndihma psikologjike, shërbime të specializuara, klasa prindërore, mbështetje për aksesin në shërbime, etj.

Nën mbështetjen dhe bashkëpunimin me ekipin koordinues të programit, ***Ekspteri do të angazhohet për të:***

- ***Hartuar një kurrikulë trajnimi për ofrimin e shërbimeve sociale të specializuara për fëmijët dhe familjet;***
- ***Zhvilluar dhe lehtësuar një trajnim 2-ditor për profesionistët shërbimofrues në fushën e mbrojtjes dhe mbështetjes sociale.***

Detyrat dhe përgjegjësitw:

a. Hartimin e kurrikulës

Hartimin e strukturës së kurrikulës që mbulon:

- Analizimin e kuadrit përkatës të ofrimit të shërbimeve të specializuara, udhëzimeve përkatëse, burime mbi praktikën pozitive, kombëtare dhe ndërkombëtare, etj;
- Parimet e ofrimit të shërbimeve sociale (bazuar në standarde të miratuara dhe përshtatja me kontekstin);
- Përgjegjësitë e institucioneve publike dhe ofruesve të kujdesit;
- Procesin e vendim-marrjes multidisiplinare për hartimin e planeve të ndihmës dhe ofrimi i shërbimeve;
- Vlerësimin, ndjekjen dhe monitorimin e rasteve gjatë marrjes së shërbimit dhe më pas;
- Hartëzimi i shërbimeve në nivel vendor dhe qendror;
- Përshtatjen e përmbajtjes për përdorim në trajnim.

b. Zhvillimin e trajnimit 2-ditor

- Përgatitjen e axhendës ditore të trajnimit dhe metodologjisë- guidws sw trajnimit (praktika ndërvepruese, raste studimore, role play, etj);
- Hartimin e materialeve të trajnimit (prezantime, fletë pune, udhëzues për lehtësuesit);
- Lehtësimin e trajnimit 2-ditor me pjesëmarrës të përzgjedhur nga njësitë vendore dhe organizatat partnere (në secilën bashki);
- Hartimin e një raporti mbi trajnimin, vlerësimet dhe rekomandimet për hapat në vijim.

Materialet që duhet të dorëzojë eksperti

- Kurrikulë e plotë për trajnimin mbi kujdesin alternativ dhe monitorimin e kinship care;
- Paketë e plotë trajnimi (axhendë, prezantime, ushtrime praktike, fletë pune, pre dhe post teste);
- Raport përmbledhës i trajnimit me analiza të vlerësimeve nga pjesëmarrësit për secilën bashki.

Koha e mundshme e fillimit të punës është Korrik 2025.

Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit është përgjatë periudhës korrik 2025- shtator 2025.

Kjo ekspertizë përfshin:

- ***Hartim kurrikule dhe raportim- 10 ditë***
- ***Zhvillim trajnimi - 4 ditë (2 ditë në Durrës+ 2 ditë në Korçë).***

Kualifikimet:

- Diplomë universitare në Shkencat Sociale (psikologji, punë sociale, edukim, shkenca sociale ose fusha të ngjashme)
- Kualifikime që lidhen me çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, kujdesit alternativ, deinstitutionalizimit, shërbimeve dhe mbrojtjes sociale;

Eksperiencat:

- Të ketë experience pune mbi 10 vjet përvojë pune në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, shërbimeve sociale dhe deinstitutionalizimit;
- Eksperienca të mëparshme në hartimin e kurrikulave dhe lehtësimin e trajnimeve për profesionistë;
- Të jetë njohës shumë i mirë i paketës ligjore për politikën e mbrojtjes së fëmijëve, shërbimeve sociale;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, prezantimi dhe ndërveprimi me grupe të ndryshme si dhe të menaxhimit të situatave
- Aftësi për të përshtatur materialet sipas grupit të synuar dhe kontekstit lokal.
- Të kuptojë dhe të dakortësojë me misionin dhe qëllimin e Nisma ARSIS
- Aftësi shumë të mira në arritjen e afateve, për të punuar në presion kohe, në punë në grup dhe në mënyrë të pavarur.

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

Procedura e aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për këtë thirrje duhet të dërgojnë me email:

1. CV-në;
2. Letër interesi;
3. Letër angazhimi/disponueshmërie;
4. Ofertën financiare.

brenda datës **10 korrik 2025** në adresën info@nisma-arsis.org , ose me postë në adresën: Rruga "Sali Butka", Pallati T.B.M, Shkalla 2, Apartamenti 1, Kati 1, Njësia Bashkiake Nr.7, PC 1023, Tirana Albania..

Procedura e Vlerësimit:

Zgjedhja e ekspertit do të bazohet në:

- se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës,
- eksperiencat e relevante të mëparshme
- oferta financiare
- gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në %
Kualifikime	30%
Eksperiencë pune	50%
Oferta financiare	20%

Ju lutemi, në vemendjen tuaj që:

- në subjekt të emailit ose zarfit ku dërgohet aplikimi të vendoset: ***Aplikim për thirrjen për ekspert për realizimin e kurrikulës dhe trajnimit mbi ofrimin e shërbimeve sociale të specializuara për profesionistët në Bashkinë Korçë & Durrës***
- vetëm personat e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.